



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Z. Ismet SOPI  
Pronar  
"Radio Drenasi"  
Nr. i biznesit 70383423  
R023  
Radio Drenasi  
Komuna e Drenasit

Ref: 1312/1772/KPM/ni

Z. Arton BERISHA  
Kandidat i propozuar për pronar  
ALBATEC. Sh.p.k.  
Nr. i biznesit 70964880  
Personi i autorizuar  
Znj. Lavdije KRASNIQI

## VENDIM

*lidhur me ndryshimin e pronësisë së Radio Drenasi – Komuna e Drenasit*

### Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Radio Drenasi është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio-Vizuale me mbulim lokal, i cili është i licencuar për të transmetuar radio programe në Komunën e Drenasit. Radio Drenasi është pajisur me licencë afatgjatë të të KPM-së me datën 30 tetor 2009 dhe vlefshmëria e saj është 7 vite nga data e licencimit.
3. Me datën 11 tetor 2013, "Radio Drenasi" ka dorëzuar në zyrën e KPM-së, një kërkesë për ndryshimin e pronësisë duke propozuar që pronësia të bartet tek kandidati i propozuar ALBATEC. Sh.p.k. i cili është në pronësi të z. Arton Berisha.
4. Në bazë të udhëzimit të KPM-së, të datës 15 maj 2014, për plotësim të kërkesës me dokumentet përkatëse, kandidati për pronarë të ri i ALBATEC. Sh.p.k. për licencë të

KPM-së, me datën 29 maj 2014 ka dorëzuar dokumentet e kërkuara dhe ka plotësuar kërkesën e tij.

5. Në kërkesën për ndryshimin e pronësisë së “Radio Drenasit” thuhet se, arsye për ndryshimin e pronësisë janë aktualisht kushtet jo të mira financiare të pronarit aktual z. Ismet SOPI, të cilat i vështirësojnë menaxhimin dhe zhvillimin e subjektit transmetues.
6. Pronari aktual është deklaruar se, edhe pas ndërrimit të pronësisë, ai do të vazhdojë të jetë i angazhuar në subjektin transmetues në cilësinë e kryeredaktorit të Radio Drenasit.
7. Kandidati për pronarë të ri të Radio Drenasit, z. Arton BERISHA, që nga viti 2004 a qenë i angazhuar në menaxhimin dhe mirëmbajtjen e subjektit transmetues Radio Drenasi.
8. Kandidati për pronarë të ri të Radio Drenasit z. Arton BERISHA është deklaruar se veç ka filluar të bëjë investimet në teknologji të re të transmetimit të radio programeve dhe si rezultat i këtij investimi është përmirësuar dukshëm kualiteti i shërbimeve programore duke ndikuar edhe në rritjen e nivelit të dëgjueshmërisë së Radio Drenasit.
9. Kandidati për pronarë të ri është shtetas Kanadez, i lindur në Republikën e Kosovës, kurse ligjërisht person i autorizuar i biznesit ALBATEC SH.P.K. është znj. Lavdije KRASNIQI, banore dhe shtetase e Republikës së Kosovës.

#### Arsyetimi

10. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja”*.
11. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së”*.
12. Neni 15. pika 2. Paragrafi 1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së”*
13. Neni 15.4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t’i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t’iu dhënë një licencë.”*
14. Prandaj, në pajtim me nenin 15.4 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, Komisioni, konkludon se kandidatit të propozuar për pronar t’i transferohet licenca, i përmbush kriteret dhe standardet e kualifikimit për licencë të KPM-së.



15. Arsyetimin për bartje të pronësisë nga ana e parashtruesit të kërkesës, KPM e pranon si të mjaftueshëm dhe në shërbim të interesit publik, duke marrë parasysh dëshmitë dhe propozimet zhvillimore në skemën programore dhe në investimet teknologjike të propozuara nga kandidati për pronarë të ri të Radio Drenasit, duke ndikuar pozitivisht në shërbimin publik në Komunën e Drenasit.
16. KPM vlerëson se ndryshimi i pronësisë së Radio Drenasi nuk do të ndikojë negativisht në ndryshimin e formatit të programit dhe nuk do të ketë ndryshime në zonë e mbulimit.
17. KPM vlerëson se kandidati për pronarë të ri të “Radio Drenasi” ka njohuri profesionale në menaxhimin e radio stacionit, pasi që i njëjti ka punuar për një kohë të gjatë në këtë subjekt transmetues.

### **VENDIM**

18. KPM merr vendim për ndryshimin e pronësisë së “Radio Drenasi” dhe të bartë licencën e KPM-së tek ALBATEC SH.P.K. me pronarë z. Arton Berisha.

### **Lëshimi i Vendimit**

19. Këtë vendim e lëshon Komisioni i Pavarur i Mediave dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit të tij.

  
\_\_\_\_\_  
Adnan MEROVCI  
Kryetar  
Komisioni i Pavarur i Mediave

11.06.2014  
datë